



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



Komiteti për Politikë dhe Financa

Nr. 02/136

Datë: 04.05.2018

Procesverbal
i mbledhjes se II (e dytë) e Komitetit për Politikë dhe Financa

Rend dite

1. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/439 datë:22.03.2018 për marrjen e vendimit për dhënien në shfrytëzim të pishinës publike në fshatin Banjë, KK-Malishevë.
2. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/481 datë:30.03.2018 për iniciimin e procedurave për ndërrim të destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore për z. Enver Kastrati nga fshati Maxharrë.
3. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/97 datë:11.04.2018 e parashtruar nga Shefi i grupit të anëtarëve të Kuvendit të Lëvizjes VETËVENDOSJE, për rikthimin e të drejtës së parkimit të makinave përgjatë rrugës Rilindja Kombëtare (Ibrahim Mazreku).
4. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/79 datë:05.04.2018, e parashtruar nga z.Maliq Paqarizi nga fshati Dragobil, për ndërrim të destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.
5. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/69 datë:03.04.2018, e parashtruar nga z. Adem Hoti nga Malisheva, për ndërrim të destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.
6. Shqyrtimi i kërkesave.
7. Të ndryshme.

Mbledhja filloj në ora 13, morën pjesë 5 anëtarë të KPF, përfaqësuesi i Osbe, zyra për informim, qytetar.

Rahim Morina: Ju përshëndes të gjithëve jemi në mbledhjen e dytë rendin e ditës e keni me material, janë edhe disa kërkesa.

A keni dikush diçka për rendin e ditës.

Alban Krasniqi: Ne në Kuvend kemi aprovuar edhe planin e punës, mirë është çdo pikë të trajtohet.

Raimonda Krasniqi: Nëse ka pika që s'janë kompletuar me material të shtyhen.

Alban Krasniqi: Ne duhet ti fusim pikat që janë me plan punë, pikat që kanë mbet, dhe ato që duhet të hyjnë.

Hashim Hoxha: Unë mendoj se pikat që janë kanë në plan punë duhet të trajtohen, të dihet kush po neglizhon cila drejtori, pa material nuk duhet të hyn asnjë pikë e me dal kuvendi jo efikas.

Rahim Morina: Në plan të kuvendit ceken disa pika por vetëm raporti tre mujor financiar ka qenë gati pika tjera jo unë secilit drejtor me shkrim ja kam dërguar planin e punës dhe pikat e secilit që kanë për kuvend.

Alban Krasniqi: Në rend dite te futen pikat që kanë mbete nga mbledhja e kaluar, por ne plan është zbatimi i planit komunal për eficiencë dhe duhet të merren masa edhe nga Institucionet, dhe kjo nënkupton qysh duhet me ruajte energjinë si qytetarët por edhe personat juridik. Është një pikë rreth barazisë gjinore në institucione, ne si kuvend duhet ta debatojmë dhe me nxjerrë një dokument të përbashkët për drejtoritë. Është edhe pika raporti i punës 2017 dhe plani i punës 2018 i QPS që kanë mbet pa u trajtuar.

Rahim Morina: Kush jeni që pika debat për barazinë gjinore të hyn në këtë rend ditë? Unanimisht ishin për.

Hashim Hoxha: Të futet në rend dite edhe pjesëmarrja e Komitetit për Arsim në organizimin e ekskursioneve të rritet më shumë transparencë, është edhe si bazë mbështetëse, rritet siguria më shumë dhe këta mundën me vëzhguar këtë proces. Ka pas raste janë organizuar ekskursione pa ditë fare drejtoria për arsim pra ky komitet ta këtë rolin mbikëqyrës.

Alban Krasniqi: Komiteti për Arsim të merr pjesë si monitorues në organizimin e ekskursioneve, ligjërisht ka të drejtë edhe pse fatkeqësisht qasja në dokumente ka qenë e vështirë.

Rahim Morina: Nëse e fusim si pikë duhet me formuluar mirë si pikë.

Alban Krasniqi: Mundet të jetë shqyrtimi i kërkesës së PDK që komitetit të Arsimit t'i jepet kopetencë specifike në monitorimin e organizimeve të ekskursioneve.

Muharrem Morina: Ky komitet me punën e tij veç i ndihmon kryetarit të Komunës në punën e tij, por ju kuptoni që ky komitet veç e ka këtë kompetencë.

Rrahim Morina: Kryesuesi i komitetit të Arsimit veç ka kërkuar që të jenë monitorues në këtë proces. Edhe drejtori i QPS ka pas me punu diçka shtesë në raportin e tij dhe aj do ta sjellë.

Alban Krasniqi: Një kërkesë që ka qenë për ndërrim të destinimit s'mundët me ardhë nëse drejtorja ska sjellë ndonjë plan, drejtorja për Gjeodezi është dashtë me sjellë informacione.

Rrahim Morina: Nëse drejtorja nuk sjellë ndonjë informacion shtesë në atë kërkesë kem me miratuar.

Hashim Hoxha: Ne s'marrim përgjegjësi nëse ata nuk sjellin informacione në këto kërkesa.

Rrahim Morina: Herëve tjera nëse shtyhen ne i fusim prapë në KpF, sepse edhe për kërkesën për sallën e sporteve në Drenovc ju patëm thënë merri me këtë çështje.

Alban Krasniqi: Te raporti financiar momentin kur trajtohet nuk duhet te sillen letra, pse ne ju kemi thënë me material sillni edhe listat ku është punuar dhe ku janë shkuar mjetet.

Rrahim Morina: Kush jeni për këtë rend të ditës? Unanimisht ishin për 5 anëtarët e KpF.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/439 datë:22.03.2018 për marrjen e vendimit për dhënien në shfrytëzim të pishinës publike në fshatin Banjë, KK-Malishevë.

Alban Krasniqi: Mungojnë dokumentet rreth realizimit të kontratës se në çfarë gjendje a kanë, dhe çfarë është tani. Ajo është pasuri publike dhe mungon raporti i kontraktorit lidhur me zbatimin e kontratës. Ne jemi që kjo pishinë të jetë në shfrytëzim të Komunës me një mirëmbajtje të vogël komuna mundet me menaxhuar.

Muharrem Morina: Për informacion kërkesa ju ka drejtuar Kuvendit, por keni parasysh që pala ka kontrate deri me 22 Qershor për shfrytëzim. Si sugjerim ju mund të kërkonit raport për të hyrat 2017-2018, raportin prej bankave dhe me pas sa ka borxh, DShP sjellë gjendjen faktike, sepse vërshimet kur janë kanë dhe një shpim komuna që e ka pas bërë i ka pas bërë dem kontraktorit që ka pas pishinën në shfrytëzim edhe a pas ankue, por me pas Komuna në shfrytëzim s'besoj që ka me pas sukses.

Hashim Hoxha: Në shfrytëzim pishinën a e ka pas një kompani apo dy.

Rrahim Morina: Qysh privatniku me kriju aty të hyra 22 mijë e Komuna 700 ose 800 krejt si neglizhencë e drejtorive po vijmë ne qetë gjendje.

Muharrem Morina: Ju futne si pikë për kuvend aty kërkon material shtesë.

Valon Krasniqi: Gjendja në atë pishinë se di si ka shkue, por komuna a mundet me ndryshuar gjendjen, dhe qysh mundet me ndodhë që banoret e Banjës mos me pagu hyrjen se kjo ndikon në buxhet.

Rrahim Morina: Kush jeni me rekomandua këtë pikë për kuvend me kusht që të kërkohej material shtesë këto çka u kërkuan këtu? Unanimisht ishin për.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/481 datë:30.03.2018 për iniciimin e procedurave për ndërrim të destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore për z. Enver Kastrati nga fshati Maxharrë.

Alban Krasniqi: Mirë është të sillet një sugjerim nga drejtoritë përkatëse.

Rrahim Morina: Nëse këto prona i kanë blerë te sillen edhe aktvendimet.

Hashim Hoxha: Është mirë me pa edhe planin e ndërtimit, sepse ndoshta palët i kanë ndërtuar objektet.

Valon Krasniqi: Jam që kjo kërkesë të rekomandohet për kuvend.

Raimonda Krasniqi: Sa kemi mundësi me pa se mos janë dertuar këto objekte.

Muharrem Morina: Për ndërtim të objekteve kërkohej legalizim pas ndërrimit të destinimit janë disa procedura.

Rrahim Morina: Kush jeni kjo kërkesë të rekomandohet? Unanimisht ishin për.

3. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/97 datë:11.04.2018 e parashtruar nga Shefi i grupit të anëtarëve të Kuvendit të Lëvizjes VETËVENDOSJE, për rikthimin e të drejtës së parkimit të makinave përgjatë rrugës Rilindja Kombëtare (Ibrahim Mazreku).

Rrahim Morina: Për këtë pikë ska ndonjë vendim një dihet se parkimi është i ndaluar.

Muharrem Morina: Bizneset janë ankuar kur janë ndaluar parkimet, ju mirë është me kërkuar nga drejtorja për Urbanizëm dhe shërbime publike a lejohet apo jo, sepse mendoj se nuk i plotëson kushtet për parking shpesh ka ndodhë që edhe makinat e emergjencës janë bllokuar.

Alban Krasniqi: Ka pas ankesë nga bizneset kur a ndaluar parkingun, por aty duhet parkuar veç makinat e vogla parkimi aty a ndalu pa te drejtë, sepse parkingun ju lehtëson gjëndrën edhe bizneseve edhe konsumatorëve e me vonë duhet guxim me zgjidh këtë problem dhe mi vendosë shenjat.

Hashim Hoxha: Unë mendoj se për parking të veturave aty duhet edhe me pagu ata që ndalohen e Komuna mundet edhe me punësuar dikë dhe me krijuar të hyra për Komunën.

Alban Krasniqi: Duhet me biseduar dhe Komuna me kriju rregull, kurse për vendosje të pagesës mundet me vendosë edhe komiteti i urbanizmit, sepse ajo rrugë është dashtë mu ndalu për automjete sepse Malisheva ska as sheshe.

Rahim Morina: Kush jeni më rekomanduar këtë pikë për kuvend? Unanimisht ishin për.

4. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/79 datë:05.04.2018, e parashtruar nga z.Maliq Paçarizi nga fshati Dragobil, për ndërrim të destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.

Rahim Morina: Kush jeni më rekomanduar këtë pikë për kuvend? Unanimisht ishin për.

5. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/69 datë:03.04.2018, e parashtruar nga z. Adem Hoti nga Malisheva, për ndërrim të destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.

Rahim Morina: Kush jeni më rekomanduar këtë pikë për kuvend? Unanimisht ishin për.

6. Shqyrtimi i kërkesave

Kërkesa nr.02/64 e parashtruar nga Ilir Gajraku nga fshati Gajrak.

Rahim Morina: E kam lexuar kërkesën edhe ju po ju lexoj për disa rrugë nëpër varreza e krejt kto janë pronë publike.

Alban Krasniqi: Duhet drejtorja e Gjeodezisë me na sqaruar.

Hashim Hoxha: Te varrezat janë disa rrugë atje përreth, por me ditë qysh është gjendja faktike.

Rahim Morina: T'i përcillet drejtorisë për Gjeodezi për sqarime, kush jeni ti kërkohet drejtorisë për sqarime në lidhje me këtë kërkesë? Unanimisht ishin për.

Kërkesa nr.02/68 e datës: 30.03.2018 e Lagjes Bacaliu në Kijevë.

Rahim Morina: Kur ka qenë komisioni për emërtimin e rrugëve atëherë më ankesë e kemi shqyrtuar, mirëpo kësaj kërkesë i japim përgjigje se kërkesat individuale nuk mund të zgjidhen, por kur do që trajtohen kërkesat tjera duhet ne përgjithësi ti shqyrtojnë.

Unanimisht ishin për që kjo kërkesë të trajtohet kur të shqyrtohen edhe kërkesat tjera.

Kërkesa nr.02/59 nr.02/59 datë: 26.03.2018 për ndërrimin e pronës publike me pronë private.

nga Isak Limaj nga fshati Banjë.

Rahim Morina: Ne këtë kërkesë ja dërgojmë kryetarit më shkresë përcjellës e kryetari le t'i përgjigjet.

Kërkesa nr.02/110 nga Zenun Krasniqi nga fshati Astrazup për ndërrim të destinimit

Unanimisht ishin për të rekomandohet për kuvend.

Kërkesa nr.02/98 të datës: 03.04.2017 për kompensim të pronës private me pronë publike e parashtruar nga Sabit Mazreku

Rahim Morina: Këtij ju ka marrë një pjesë për rrugë e ju kanë dhënë 2 me 1 por me matje atëherë i kanë dhënë më pak e tash po e kërkon pjesën tjetër.

Këtij ju ka dhënë afër Radio Malishevës e ju ka marrë të shkolla fillore, Komuna duhet me ditë a ka mundësi meja kompensua me pronë apo me pare.

Alban Krasniqi: Mas pari duhet komisioni me pa si ka ndodhë kjo, ose pala të kërkojë të drejtën e tij në Gjykatë.

Muharrem Morina: Me mirë më udhëzuar palën në Gjykatë, sepse me ligj janë shumë procedura, drejtori i Gjeodezisë ka thënë se për të kjo çështje është e pa qartë.

Rahim Morina: Ti kthehet palës përgjigje që t'i ndjekë rrugët gjyqësore, kush jeni që palës t'i japim përgjigje që t'i drejtohet Gjykatës? Unanimisht ishin për që pala t'i drejtohet Gjykatës.

Kërkesa nr.02/68 datë: 05.04.2018 nga Shpejtim Sertolli nga Bellanica.

Alban Krasniqi: Këtë kërkesë e kishim debatuar edhe në kuvend, me pas parasysh për të ardhmen se tani është edhe rishikimi i buxhetit.

Rahim Morina: Kush jeni ta përcjellim për Kuvend këtë kërkesë? Unanimisht ishin për që kjo kërkesë të shkon në kuvend për debat.

Kërkesa nr.02/103 datë: 12.04.2018 nga Burim Krasniqi nga fshati Damanek.

Rahim Morina: Kjo kërkesë t'i kthehet palës me përgjigje si e pa kompletuar.

Kërkesa nr.04/25 nga grupi i këshilltareve të PDK-së në Malishevë.

Rahim Morina: Kërkesën e kanë bere për debat në Kuvend lidhur me punësimet në kontratë në vepër, si dhe disa punësime që janë bërë nëpër fshatra. Mendoj të sillen një raport nga kryetari për punësimet në Komunë dhe disa institucione tjera në Hidroregjion, Ekoregjion. Kush jeni që kryetari të përgatis një raport për punësimet?

Unanimisht për ishin të bëhet raport në kuvend.

Kërkesa nr.02/106 datë : 13.04.2018 nga Emine Vrenezi.

Rrahim Morina: Kjo është një gjendje jo të mire ekonomike e ka vetëm një djalë.

Muharrem Morina: Kenë parasysh që vendimet i ekzekuton Kryetari i Komunës.

Alban Krasniqi: Kjo shumë aspak se ndihmon dhe në Komunitet tjerë Kryetari ndan deri në 1 mijë euro me shumë pastaj kuvendi, unë këtë shumë kisha thënë nëse i ndahet t'i jepet në dy kështë e jo menjëherë.

Rrahim Morina: Kush jeni për miratimin e kësaj kërkesë pra që t'i ndahen 500 euro në dy kështë nga 250 euro? Unanimisht ishin për.

7. Të ndryshme.

Alban Krasniqi: Ju kemi ofruar një draft Rregullore për rrugët lokale bazuar në udhëzimin administrativ mendoj se Rregullorja obligon Komunën me kanë me rigorozë për pranimet teknike, në proces janë edhe dy rregullore për Arsim dhe për subvencione e sidomos në Bujqësi.

Raimonda Krasniqi: Rregullorja e vitit 2010 ka qenë shumë mire e precizuar sa i përket Arsimit.

Rrahim Morina: Ju falënderoj për pjesëmarrje

Mbledhja përfundoi në ora 15.50 min.

Procesmbajtësi

Naim Avdijaj jur. i dip

